

VENDIM
Nr.959, datë 24.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT
TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK TË
KRYERA NGA MINISTRIA E BRENDSHME, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si autoritet kontraktor, të realizojë, brenda datës 20 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit, për objektet e specifikuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit	Objekti i prokurimit	Shënim
1	Ministria e Brendshme	16 100 978	Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyre	Njoftim fituesi
2	Ministria e Brendshme	4 629 064	Blerje materiale të ndryshme për pastrim	Njoftim fituesi
3	Ministria e Brendshme	31 723 695	Blerje uniforma,veshmbathje dhe elemente të tjera përbërës të tyre	Njoftim fituesi
4	Ministria e Brendshme	32 885 548	Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni	Njoftim fituesi
5	Ministria e Brendshme	104 132 044	Blerje karburanti në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
6	Ministria e Brendshme	77 990 629	Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
7	Ministria e Brendshme	32 429 167	Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
8	Ministria e Brendshme	21 059 442,90	Blerje letër në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
9	Ministria e Brendshme	169 275 215	Shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes	Njoftim fituesi
10	Ministria e Brendshme	5 517 000	Blerje këpucë	Njoftim fituesi
11	Ministria e Brendshme	133 921 981	Shërbim gatimi	Njoftim fituesi

